BASHKIA
TIRANË

NR. PROT. 28547/2

MEMO

TIRANË - 17/7/2019

*Drejtuar:* **Z. ERION VELIAJ** KRYETAR I BASHKISË

*Drejtuar:* **ZNJ. ERKA MATO** DREJTOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË

*Nëpërmjet:* **Z. DITJON BABOÇI** DREJTOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

*Nga:*

**ZNJ. ANISA MANÇE** DREJTOR
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

**Z. DEVIS AGARAJ** PËRGJEGJËS
SEKTORI I MAKROPLANIFIKIMIT

*Përgatiti:* **ZNJ. SOVIELA SHEHU** SPECIALISTE
SEKTORI I MAKROPLANIFIKIMIT

**Z. ALKET HAKIRAJ** SPECIALIST/JURIST
SEKTORI I MIKROPLANFIKIMIT

***Lënda:*** Miratimin e nismës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.

E nderuar znj. Mato,

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bazë të Venditim nr. 28547 datë 17.07.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit të

Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë , të miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), pasi pregatiti dokumentacionin e anazizës së plotë të elementëve të territorit të cilat propozohen të rishikohen ka ndërmarrë nismën për rishikimin e tij.

*Sa më sipër ju përcjellim për afishim njoftimin bashkëlidhur dhe Dokumentin e analizës së plotë të elementëve të territorit si dhe materialin hartografik përkatës të cilat propozohen të rishikohen në PPV.*

BASHKIA
TIRANË

# NJOFTIM

Njoftohen të gjithë subjektet e interesuar se Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bazë të Venditim nr. 28547 datë 17.07.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë , të miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), pasi pregatiti dokumentacionin e analizës së plotë të elementëve të territorit të cilat propozohen të rishikohen ka ndërmarrë nismën për rishikimin e tij.

Gjithashtu, informojmë se në bazë të pikës 4/b, shtojca 1 të Udhëzimit Nr.01, datë 22.02.2019 të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për "Për hartimin, bashkrendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar", dëgjesa / takimi publik me grupin e punës do të zhvillohet në datë 01.08.2019 pranë ambienteve të Bashkisë Tiranë.